




KAMPIONATI EKIPOR KOMBËTAR / KUPA E REPUBLIKËS

OPEN – KATEGORIA I

KAMPIONATI EKIPOR
KOMBËTAR FEMRA

 **24–30 GUSHT 2026**

 **SHTËPIA E SHAHUT – Zayed Center, TIRANË**



Organizuar nga
Federata Shqiptare e Shahut



FEDERATA SHQIPTARE E SHAHUT

KAMPIONATI EKIPIOR KOMBËTAR / KUPA E REPUBLIKËS

OPEN - KATEGORIA I

KAMPIONATI EKIPIOR KOMBËTAR FEMRA

24-30 GUSHT 2026 |

SHTËPIA E SHAHUT- TIRANË

1. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Kjo rregullore përcakton organizimin, pjesëmarrjen, sistemin e garimit, kriteret teknike, fondin e çmimeve dhe rregullat e brendshme për aktivitetet e mëposhtme:

- Kampionati Ekipor Kombëtar Open - Kategoria I, 24-30 gusht 2026;
- Kampionati Ekipor Kombëtar për Femra, 24-30 gusht 2026.

Në të dy kampionatet zbatohen Ligjet e Shahut të FIDE-s, rregulloret përkatëse të FIDE-s dhe aktet e Federatës Shqiptare të Shahut (FSHSH).

2. VENDI DHE ORGANIZIMI

Garat do të zhvillohen në ambientet e Shtëpisë së Shahut “Zayed Center”, Tiranë. Organizatore është Federata Shqiptare e Shahut. <https://maps.app.goo.gl/eJCGmT7jga36qJ6p7>

3. Pjesëmarrja

3.1 Open - Kategoria I

Në Kampionatin Ekipor Open 2026 marrin pjesë tetë ekipet e Kategorisë I:

1. K.S. Butrinti
2. S.K. Tirana
3. K.S. Teuta
4. K.S. Partizani
5. Flamurtari
6. Luftëtari
7. Lezha
8. Valbona

3.2 Femra

Në Kampionatin Ekipor për Femra marrin pjesë ekipet e konfirmuara nga klubet anëtare të FSHSH-së.

1. S.K. Tirana
2. S.K. Teuta
3. S.K. PARTIZANI
4. Tirana Junior

4. Tarifa e pjesëmarrjes

Tarifa e pjesëmarrjes është 50-euro për çdo ekip, për secilin kampionat. Regjistrimi quhet i përfunduar pas konfirmimit nga FSHSH dhe shlyerjes së tarifës përkatëse.

5. Përbërja e ekipeve

- Çdo ekip përbëhet nga 4 lojtarë titullarë dhe deri në 2 lojtarë rezervë; rezervat nuk janë të detyrueshme.
- Ndeshjet zhvillohen në 4 tavolina.
- Në të njëjtën ndeshje nuk mund të aktivizohen më shumë se 2 lojtarë të federuar me federatën të ndryshme nga FSHSH. Lojtarët nga Kosova konsiderohen vendas për këtë kufizim.

- Renditja bazë e lojtarëve, e dorëzuar dhe e miratuar para fillimit të garës, nuk mund të ndryshohet gjatë kampionatit.

6. Sistemi dhe koha e lojës

6.1 Open - Kategoria I

- Sistem rrethi (Round-Robin), 7 raunde, i vlefshëm për ELO Rating.
- Koha e mendimit: 90 minuta + 30 sekonda shtesë për çdo lëvizje, duke filluar nga lëvizja e parë.
- Ekipi i renditur i pari shpallet Kampion Kombëtar Ekipor Open për vitin 2026.
- Dy ekipet e renditura në dy vendet e fundit kalojnë në Kategorinë II për vitin 2027.

6.2 Femra

- Sistem rrethi (Round-Robin), i vlefshëm për ELO Rating. Kur marrin pjesë më pak se 5 ekipe, gara zhvillohet me dy xhiro (Double Round-Robin).
- Koha e mendimit: 90 minuta + 30 sekonda shtesë për çdo lëvizje, duke filluar nga lëvizja e parë.
- Ekipi i renditur i pari shpallet Kampion Kombëtar Ekipor për Femra për vitin 2026.

7. Pikëzimi dhe kriteret e renditjes

Fitore në ndeshje: 2 pikë; barazim: 1 pikë; humbje: 0 pikë.

Në rast barazimi me pikë ndeshjeje (Match Points), renditja përcaktohet sipas kësaj radhe:

1. rezultati i ndeshjes direkte;
2. pikët e grumbulluara në tavolina (Board Points);
3. Sonneborn-Berger for Teams; (EMGSB)

8. Çmimet dhe trofetë

Fondi i përgjithshëm i çmimeve për të dy kampionatet është 2,600 euro.

Kupa, medalje dhe diploma u jepen ekipeve të tri vendeve të para.

OPEN**FEMRA**

Ekipi - vendi i pare	1, 000 €	Ekipi - vendi i pare	500 €
Ekipi - vendi i dytë	500 €	Ekipi - vendi i dytë	300 €
Ekipi - vendi i tretë	200 €	Ekipi - vendi i tretë	100 €

9. Programi

Data	Aktiviteti	Ora
24 gusht	Paraqitja e ekipeve	15:30
	Mbledhja teknike /ceremonia e hapjes	16:00
	Raundi 1	16:30
25 gusht	Raundi 2	16:30
26 gusht	Raundi 3	16:30
27 gusht	Raundi 4	16:30
28 gusht	Raundi 5	16:30
29 gusht	Raundi 6	16:30
30 gusht	Raundi 7 / ceremonia e mbylljes	10:00

Programi mund të përshtatet nga organizatori dhe kryearbitri në varësi të numrit përfundimtar të ekipeve të femrave. Çdo ndryshim u komunikohet ekipeve në mbledhjen teknike.

10. Dorëzimi i formacionit

- Kapitëni dorëzon formacionin e ndryshuar për raundin pasardhës brenda 1 ore nga përfundimi i ndeshjes së ekipit të tij. Pas këtij afati mbetet në fuqi formacioni bazë.

11. Sjellja në sallën e lojës

- Kapitëni mund të komunikojë me lojtarët e ekipit vetëm për çështje të lejuara nga rregulloret dhe në prani të gjyqtarit.
- Lojtari mund t'i drejtohet kapitenit për çështje të garës vetëm në prani të gjyqtarit.
- Lojtarët nuk mund të largohen nga zona e lojës pa lejen e gjyqtarit gjatë zhvillimit të garës.
- Telefonat celularë dhe mjetet e tjera elektronike trajtohen sipas Ligjeve të Shahut të FIDE-s dhe udhëzimeve të kryearbitrit. Pajisjet duhet të jenë të fikura dhe të depozituara sipas procedurës së njoftuar në mbledhjen teknike.
- Ndalohet përdorimi i shënimeve, burimeve të informacionit, këshillave dhe analizimi në një tabelë tjetër gjatë garës.
- Ndalohet pirja e duhanit në sallën e lojës.
- Vonesa mbi 15 minuta nga fillimi i raundit sjell humbjen e lojës, përveç rasteve kur kryearbitri vendos ndryshe për arsye të justifikuar.
- Pas përfundimit të lojës, lojtarët largohen nga zona e lojës. Në sallë lejohen vetëm lojtarët, kapitenët, gjyqtaria dhe personat e autorizuar.

12. Komisioni i Apelit dhe ankesat

Komisioni i Apelit:

- IA Marin Collaku
- IA Pandi Borova
- IA Shkelqim Lazaj

Ankesa paraqitet me shkrim pranë gjyqtarisë brenda 15 minutave nga përfundimi i ndeshjes që kundërshtohet. Tarifa e ankesës, nëse vendoset, dhe procedura e shqyrtimit njoftohen në mbledhjen teknike.

13. Drejtimi dhe kontaktet

Drejtores e turneut	Majlinda Pilinci	pilincimajlinda@gmail.com WhatsApp: +355 69 258 9298
Kryearbitër	Kristaq Andoni	WhatsApp: +355 69 247 6999
Arbiter	Petro Boci	WhatsApp: +355 69 673 4368
Arbiter	Toni Didi	WhatsApp: +355 68 466 0889
Oficer ratingu	Marin Collaku	

14. Dispozita përfundimtare

- Çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë rregullore zgjidhen nga kryearbitri dhe organizatori, në përputhje me rregulloret e FIDE-s dhe të FSHSH-së.

FEDERATA SHQIPTARE E SHAHUT

Tiranë, 21 / 08 / 2026